



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE**

**Nr. 08**

**Datë:** 14. 02. 2020. Ora: 10:00

**Vendi:** Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

**Kryesues i mbledhjes:** Alim Rama, anëtar i KQZ-së

**Në mbledhje morën pjesë anëtarët e KQZ:** Sami Hamiti, Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Eshref Vishi, Rifat Krasniq, Čemailj Kurtiši, Artan Asllani.

**SKQZ:** Yll Buleshkaj, u.d. i Kryeshefit

**Përkthyes:** Argjina Misini

**Procesmbajtës:** Fehmi Ajvazi.

**RENDI I DITËS**

**1. Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

- Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.06 dhe 07/2020;

**2. Aktivitetet e ZRPP-së:**

- Caktim i Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për muajin Shkurt 2020;

**3. Raporti i Këshillave të KQZ-së**

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtim dhe miratimi i Udhëzimit për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesve në Vendvotim për zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës 2020.

**4. Të ndryshme.**

**1.Hyrje: znj. Valdete Daka, Kryesuese e mbledhjes së KQZ-së;**

*Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.06 dhe 07/2020*

**Valdete Daka:** Mirë se erdhët në mbledhjen e 9-të të KQZ-së, sa i parkete rendit të ditës, a ka vërejtje, propozime...?

Kam unë, edhe pse ndoshta është dashur me e qitë në këshill, por kërkesa është nga AWEB. Do të ketë zgjedhje në prill, në Korenë e Jugut...dhe, është kërkuar që atje t'i dërgojmë 2 pjesëmarrës me shpenzimet e organizatës...Propozoj të jetë pikë shtesë...! Nëse pajtoheni, meqë jemi edhe anëtarë, ne marrim pjesë në aktivitete, shpenzimet janë të organizatës...

Pra, kush është për këtë pikë që propozova, dhe për këtë rend dite...?

Anëtarët e KQZ-së, miratuan rendin e ditës....

## 1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr.06 dhe 07/2020;

**Čemailj Kurtiŝ:** Po, kam unë. Në mbledhjen e 7-të, mungon emri im, sepse kam qenë në atë mbledhje.

**Alim Rama:** Do vërejtje, I kam dorëzuar me shkrim...Besoj, do të plotësohen...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan procesverbalin nr. 6 të KQZ-së.

## **2. Aktivitetet e ZRPP-së:**

Caktim i Lartësisë së Mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për muajin Shkurt 2020

**Yll Buleshkaj:** Ushtruesi i detyrës së krye shefit, e informoi KQZ-në se, ende nuk është pranuar asnjë aplikacion për kandidat për kryetarë të Komunës së Podujevës, mirëpo afat ka deri të hënën me 17 shkurt. Sa i parkete rendit të ditës, para jush është draft – vendim, e kemi një praktikë dhe kështu duhet të vazhdojmë procedimin me mjetet deri sa të aprovohet buxheti...Llogaritja është bërë, shumat janë, dhe ne rekomandojmë për aprovim...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan caktim i lartësisë së mjeteve nga Fondi për Mbështetjen e Subjekteve Politike për muajin Shkurt 2020.

**Sami Hamiti:** Meqë, edhe u votua ndarja e mjeteve, kërkoj që këto mjete të procedohen sa më shpejtë...

## **3.Raporti i Këshillave të KQZ-së**

Këshilli për Operacione Zgjedhore

### 1.Shqyrtimi dhe miratimi i kandidatëve të subjekteve politike për anëtarë të këshill

komunal në Podujevë

**Alim Rama:** Këshilli, ka shqyrtuar emrat e kandidatëve të subjekteve politike për anëtarë të këshill komunal në Podujevë. Janë miratuar të pesë emrat, dhe ne i rekomandojmë KQZ-së për miratim. Këta janë:

1. *Jakup Gashi – LDK*
2. *Hakif Mehmeti – PDK*
3. *Arbër Svishta – Lëvizja “VETËVENDOSJE”*

4. *Gafurr Shabani – Nisma*

5. *Gani Shabani – AAK*

**Valdete Daka:** E kemi vendimin, a ka ndokush vërejtje...? Atëherë, kush është për...?

**Alim Rama:** Këshilli, po ashtu, ka shqyrtuar planin e sigurisë për zgjedhjet në komunën e Podujevës, plani është përpiluar në bashkëpunim me policinë, kështu që ne rekomandojmë për aprovim.

Anëtarët e KQZ-së, miratuan shqyrtuar planin e sigurisë për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 15 marsit 2020, në komunën e Podujevës.

**2.Shqyrtim dhe miratimi i Udhëzimit për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesve në Vendvotim për zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës 2020.**

**Valdete Daka:** Si edhe në zgjedhjet e kaluara, bëhet identifikimi i votuese me të drejtë vote në bazë të dokumenteve valide të identifikimit, e këto dokumente janë: letërnjoftimi, pasaporta, dokumenti i vlefshëm i udhëtimit, dhe leja e vozitjes e vlefshme. Këto janë dokumentet të parapara me nenin 90, dhe ne nuk mund të ndryshojmë...

Anëtarët e KQZ-së, miratuan Udhëzimin për Komisionin Komunal të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesve në Vendvotim për zgjedhjet jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Podujevës 2020.

**4.Ftesa nga AWEB për vëzhgimin e zgjedhjeve në Koren e Jugut**

**Valdete Daka:** Siç, edhe propozova në rendin e ditës, e kemi një ftesë të AËEB-it, organizatë ndërkombëtare e “KQZ”-ve. Shpenzimet i mbulojnë ata, ftesa është për dy persona...

Për ne, ndoshta nuk është bash e përshtatshme koha, sepse ne kemi zgjedhje. Mirëpo, unë propozoj që një anëtar i KQZ-së dhe një nga Sekretariati, megjithatë të marrë pjesë...

**Yll Buleshkaj:** Unë, pavarësisht që kemi nevojë për staf, propozoj që Valmir Elezi të jetë nga Sekretariati.

**Valdete Daka:** Nga KQZ, jeni dakord që të shkoj anëtari Ibrahim Selmanaj...!

Anëtarët e KQZ-së, miratuan këto dy propozime.